

Fillimi > -Kronikë

Video/ Kallashnikov, municion luftarak e bajoneta, si e ruanin kanabisin vëllezërit korçarë, arrestohet njëri (Emri)

04 Shtator, 2021 09:21



Madhësia e tekstit: - +

- Policia e Korçës ka goditur një rast të armëmbajtjes pa leje dhe tentativës për kultivim të bimëve narkotike.
- Gjatë aksionit, është arrestuar një 26-vjeçar, si dhe është shpallur në kërkim vëllai i tij 21-vjeçar. Gazetarja Lorena Kodra raporton për “BalkanWeb” se në pranga ka rënë i riu Romeo Myftarago.
- Gjithashtu, policia ka sekuestruar një armë zjarri tip kallashnikov, municion luftarak, krëhëra dhe bajoneta të armëve të zjarrit.

Njoftimi i policisë:

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Maliq, në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e kultivimit të bimëve narkotike dhe armëmbajtjes pa leje, si rezultat i hetimeve disa mujore të kryera nën drejtimin e Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Korçë dhe kontrollit në territor kanë evidentuar dhe goditur një rast të tentativës për kultivim të kanabisit në fshatin Selcë, Njësia Administrative Gorë, Maliq.

Në vijim të veprimeve procedurale specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Maliq, bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit R. M., 26 vjeç, banues në fshatin Selcë, Maliq dhe shpallën në kërkim vëllain e tij shtetasin D. M., 21 vjeç, banues në Libonik, Maliq, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në banesën dhe ambientet përreth saj në pronësi të shtetasve të mësipërm, u gjetën 1 armë zjarri tip kallashnikov, një sasi me municione luftarake, 2 krëhëra dhe 2 bajoneta arme zjarri, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale. Gjithashtu u konstatuan edhe disa fidanë të dyshuar kanabis, të cilat dyshohet të jenë kultivuar nga dy vëllezërit në bashkëpunim me njëri-tjetrin.

Materialet në ngarkim të tyre i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, për veprat penale “Armëmbajtja pa leje” dhe “Kultivimi i bimëve narkotike”, të kryera në bashkëpunim.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)


Etiketa: arme zjarri kanabis korce

TË NGJASHME



Ndalohet automjeti në Shëngjin, i gjenden doza kanabisi, arrestohet 22-vjeçari

09 Shtator, 2021




Tentuan të kultivonin bimë narkotike, vihen në pranga dy vëllezërit në Memaliaj

08 Shtator, 2021


Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Policia Rrugore shton kontrollet në rrugët e Tiranës gjatë fundjavës, dhjetëra gjoba për shpejtësi e alkool në timon, 5 shoferë të dehur në pranga

11 Shtator, 2021




Fier/U vra nga ish-bashkëshorti me armë zjarri, flet vëllai i viktimës

11 Shtator, 2021




Vrasje në Fier, 31-vjeçari qëllon për vdekje me armë zjarri në banesë ish- bashkëshorten

10 Shtator, 2021




U helmuan nga ushqimi, rreth 20 dasmorë përfundojnë në spitalin e Durrësit. Nisin hetimet

10 Shtator, 2021



Ra nga kangjellat e ndryshkura të hotel 'Rogner', ja vendi ku humbi jetën i riu (Foto+Video)

10 Shtator, 2021



Hotel 'Rogner' shndërrohet në skenë krimi, shemben kangjellat e ballkonit, vdes tragjikisht i riu (Emri)


10 Shtator, 2021

KATEGORIA VIDEO



Kjo Kombëtare mund të shkojë larg". Igli Tare për Sport News: Më pëlqen shpirti i garës së kuqezinjve, brez fantastik (VIDEO)

10 Shtator, 2021




Hotel 'Rogner' shndërrohet në skenë krimi, shemben kangjellat e ballkonit, vdes tragjikisht i riu (Emri)

10 Shtator, 2021



"Duhet të ishte në burg", Rama i përgjigjet akuzave të Bashës: Të mirëkuptueshme, kjo s'është ditë e lehtë për PD, duhet të kemi respekt për traumat e të tjerëve

10 Shtator, 2021



"Koha, ilaçi më i mirë", Basha: Dhimbja që ndiej në nivel personal dhe njerëzor për vendimin është dyfishuar sot nga gjuha e Berishës

10 Shtator, 2021



"Në Kuvend pakica e krimit e korrupsionit, duhet të ishin në burg", Basha flet me emra pas braktisjes së seancës: Detyra jonë, mposhtja e këtij regjimi

10 Shtator, 2021



Lindita Nikolla mban fjalën e saj të parë si Kryetare Kuvendi: Ndihem e nderuar, ta kthejmë Parlamentin në pasuri publike, e jo në hapësirë përçarëse

10 Shtator, 2021

FAQET ZYRTARE

News24

Gazeta Shqiptare

Radio RASH

PRIVATËSIA

POLITIKA E PRIVATËSISË

KONTAKT

redaksia@balkanweb.com

EMISIONE NEWS24

Alert

Emisioni Diplomaticus

Emisioni Vila 24

Kjo Javë

Klinika 24

Koha për t'u zgjuar

Me zemër të hapur

Monitor Ekonomi

Real Story

Shqiptarët për shqiptarët

Sport News

Sport News Plus

KATEGORI

Fillimi

Shqipëria

Kosova

Rajoni

Sport

Bota

Kulturë

Metropol

Analiza

Teknologji

MEDIAT E HUAJA

New York Times

Guardian

WEB BBC

WEB CNN

REUTERS

Washington Post

Times Online

Financial Times

WEB Yahoo

WEB MSN

USA Today

